

**DHOMA E POSAÇME E  
GJYKATËS SUPREME TË  
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE  
QË LIDHEN ME  
AGJENCINË KOSOVARE  
TË MIRËBESIMIT**

**SPECIAL CHAMBER OF THE  
SUPREME COURT OF  
KOSOVO ON KOSOVO  
TRUST AGENCY RELATED  
MATTERS**

**POSEBNA KOMORA  
VRHOVNOG SUDA  
KOSOVA ZA PITANJA  
KOJA SE ODNOSE NA  
KOSOVSKU  
POVERENIČKU  
AGENCIJU**

---

**ASC-10-0024**

Në padinë e

[REDACTED]

[REDACTED] Pejë

Përfaqësuar nga [REDACTED] avokat nga [REDACTED] Prishtinë

Paditësi/Ankuesi

vs

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**

**Rr. Ilir Konushevci nr. 8, Prishtinë**

E paditura

Kolegji i Ankesave pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetar i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, në ankesën e Paditësit/Ankuesit kundër aktvendimit të Trupit Gjykues të DHPGJS-se të 14 janarit 2010, SCC-08-0267, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 29 prill 2010, lëshon këtë:

**AKTVENDIM**

- 1. Ankesa refuzohet si e pabazë.**
- 2. Vërtetohet aktvendimi i Trupit Gjykues të DHPGJS-së të 14 janarit 2010 (SCC-08-0267).**

- 3. Refuzohet kërkesa për masën e ndalimit të përkohshëm si e pabazë.**
- 4. Ankuesi obligohet të paguajë taksat gjyqësore në shumën prej 60,- Euros për procedurën ankimore.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Më 7 tetor 2008, Paditësi ka ushtruar padi pranë DHPGJS-së, me të cilën ka kërkuar që të shpallet blerës legjitim i lokalit [REDACTED] të Ndërmarrjes Shoqërore [REDACTED] i cili gjendet në ish rrugën [REDACTED] [REDACTED]. Pejë, pas anulimit të shitjes së lokaleve nga Komision i Likuidimit më 18 dhjetor 2007. Shitia e lokaleve, e cila është tenderuar më 30 nëntor 2007, është anuluar nga Komisioni i Likuidimit për shkak të dyshimit të një marrëveshjeje të fshehtë mes tenderuesve. Paditësi është shpallur fitues i tenderit për lokalet. Paditësi e ka kontestuar vendimin e Komisionit të Likuidimit pranë Bordit të Drejtoreve të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit më 9 janar 2008 dhe ka deklaruar se është shkelur neni 13.7 i rregullave të tenderit për shitje dhe ka e ka njoftuar Agjencinë në pajtim me nenin 29 dhe 30 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 dhe 2005/18 (SCC-08-0267).

Më 14 janar 2010, DHPGJS-së e refuzoi padinë e Paditësit si të papranueshme për shkak se nuk i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë të parapara me nenin 28.2 (d) të UA të UNMIK-ut 2008/6. DHPGJS-ja, në arsyetimin e saj, ka pohuar se Paditësi/Ankuesi nuk e ka ushtruar padinë brenda aftit prej 9 (nëntë) muajsh nga data kur ai ka ditur ose po të kishte treguar kujdesin e duhur ka qenë e arsyeshme të dijë për vendimin apo veprimin e Agjencisë. Paditësi/Ankuesi është informuar me vendimin e Komisionit të Likuidimit më 20 dhjetor 2007, në bazë të së cilës ai e ka dërguar një ankesë dhe një njoftim tek AKM—ja më 9 janar 2008, por nuk ka marrë përgjigje nga Komisioni i Likuidimit ose nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve të AKM-së dhe si rezultat ka vazhduar me ushtrimin e padisë

pranë DHPGJS-së më 7 tetor 2008. Aktvendimi i Trupit Gjykues të DHPGJS-së i është dhënë Paditësit më 28 janar 2010.

Më 24 shkurt 2010, Paditësi/Ankuesi ka ushtruar ankesë pranë Kolegjit për Ankesa kundër aktvendimit të Trupit Gjykues. Paditësi/Ankuesi pretendon se është bërë zbatimi i gabueshëm i ligjit dhe kërkon që aktvendimi të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Paditësi/Ankuesi pohon se sipas nenit 6.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4, Paditësi mund të depozitojë vetëm padinë për kundërshtimin e një vendimi të Agjencisë brenda nëntë (9) muajve nga data kur paditësi i tillë ka ditur ose po të kishte treguar kujdesin e duhur ka qenë e arsyeshme të dijë për vendimin e caktuar dhe sipas nenit 6.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4, dispozitat e parashtruara në nenin 6.1 zbatohen pas njoftimit paraprak të Agjencisë nga ana e paditësit në pajtim me nenin 30.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12, të ndryshuar. Paditësi/Ankuesi prandaj pohon se afati prej 9 muajsh i paraparë me nenin 6.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2008/4, i aplikuar lidhur me nenin 6.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4, ka filluar të llogaritet që nga data e njoftimit të AKM-së, në pajtim me nenin 30.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12, e ndryshuar, ose "pas afatit ligjor prej 60 ditësh për përgjigje nga AKM-ja". Paditësi/ankuesi pohon se pasi e ka njoftuar AKM-në më 8 janar 2008, padia që është ushtruar më 7 tetor 2008 është brenda afatit prej 9 muajsh. Paditësi/Ankuesi më tutje pretendon çdo interpretim tjetër, i cili e ngarkon Paditësin/Ankuesin për shkak të neglizhencës së organit publik i cili i injoron paditë e palëve, do të paraqiste një shkelje flagrante të të drejtave të njeriut dhe në këtë rast, të drejtën e qasjes në drejtësi.

Më 18 mars 2010, Paditësi/Ankuesi ka ushtruar kërkesë për masën e ndalimit të përkohshëm kundër shitjes së lokaleve të përmendura që janë përfshirë në tender si shitje e aseteve të likuiduara nga Agjencia Kosovare e

Privatizimit, si [REDACTED] në rrugën [REDACTED] (më parë e njojur si rruga [REDACTED]) në Pejë.

### **Arsyet Ligjore**

#### 1. Ankesa

Ankesa është e pranueshme por e pabazë. Në bazë të nenit 63.2 të UA të UNMIK-ut 2008/6, Kolegji i Ankesave ka vendosur të refuzojë pjesën gojore të procedurës.

Neni 6.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 parasheh afatin brenda të cilit Paditësi/Ankuesi duhet të parashtronjë padinë që e kundërshton një vendim apo veprim të Agjencisë.

Neni 6.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 thotë:

*Paditësi mund të depozitojë vetëm padinë për kundërshtimin e një vendimi ose një veprimi të Agjencisë brenda nëntë (9) muajve nga: (a) data kur paditësi i tillë ka ditur ose po të kishte treguar kujdesin e duhur ka qenë e arsyeshme të dijë për vendimin a veprimin e Agjencisë dhe (b) data kur Dhoma e Posaqme njofton publikisht se është në gjendje të pranojë padi.*

Neni 6.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 thotë:

*Dispozitat e parashtruara në nenin 6.1 zbatohen pas njoftimit paraprak të Agjencisë nga ana e paditësit në pajtim me nenin 30.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12.*

Paditësi/Ankuesi në këtë ankesë paraqet mendimin se afati prej 9 muajsh fillon nga data e njoftimit të AKM-së, ose 60 ditë pasi është njoftuar AKM-ja, që në këtë rast do të nënkuptohej data e 9 janarit 2008. Paditësi/Ankuesi

është i mendimit se vendimi i Trupit Gjykues është i papranueshëm dhe se çdo interpretim tjetër, i cili e ngarkon Paditësin/Ankuesin për shkak të neglizhencës së organit publik i cili i injoron paditë e palëve, do të paraqiste një shkelje flagrante të të drejtave të njeriut dhe në këtë rast, të drejtën e qasjes në drejtësi.

Mendimi ligjor i Paditësit/Ankuesit nuk ka bazë në ligj. Nenet 6.1 dhe 6.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 të aplikuara së bashku, e parashohin afatin kohor për parashtrimin e ankesës kundër një vendimi të Agjencisë brenda nëntë (9) muajve nga data kur paditësi i tillë ka ditur ose është dashur të dije për vendimin a veprimin e Agjencisë që varet nga njoftimi paraprak i Agjencisë. Po të kishte pasur qëllim legjislatori të zgjasë afatin kohor në 60 ditë për njoftimit të Agjencisë, kjo do të përkufizohej edhe në Rreguloren e UNMIK-ut 2008/4. Qëllimi që afati është paraparë prej 60 ditëve në nenin 30.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2005/12 qëndron në atë që t'i jepet Agjencisë mundësi për një rishikim të brendshëm të vendimit të kontestuar nga paditësi i mundshëm. Kjo nuk është një mjet i duhur juridik para se të fillohet me procedurën gjyqësore, por është procedurë sui generis për t'iu shhangur gjykimeve të panevojshme. Ligji nuk parasheh që Agjencia është e obliguar ta informojë paditësin e mundshëm se a ka ndërmend të zgjidhë problemin ligjor jashtë gjykatës. Qëllimi i afatit prej 9 (nëntë) muajsh i paraparë në nenin 6 të Rregullores të UNMIK 2008/4 është të detyrohen të dyja palët, Agjencia dhe paditësi i mundshëm që të vendosin se si të vazhdojnë tutje brenda afatit të arsyeshëm kohor. Agjencia është e vetëdijshme lidhur me faktin se nëse nuk merret me argumentet e paditësit të mundshëm sa më shpejt që është e mundur, ajo rrezikon të paditet para DHPGJS-së. Paditësi i mundshëm e din se nëse ai nuk vendos lidhur me seriozitetin e dëshirës së tij për të parashtruar padi brenda afatit të paraparë me ligj, ai do ta humb të drejtën e tij. Kjo e arrin një lloj "kontroll dhe baraspeshë" (check dhe balance) e cila duket se mjafton për të arritur një siguri ligjore brenda një afati të arsyeshëm. Duke pasur parasysh këto argumente interpretuese, Kolegji i Ankesave nuk sheh shkelje të të Drejtave

të Njeriut në aplikimin e këtyre dispozitave sipas mënyrës së formulimit të tyre.

Në këtë lëndë, Paditësi/Ankuesi e ka ushtruar padinë pranë Dhomës së Posaçme më 7 tetor 2008. Paditësi/Ankuesi është informuar për vendimin e Komisionit të Likuidimit më 20 dhjetor 2007 dhe e ka njoftuar AKM-në më 8 janar 2008 në pajtim me nenin 30.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12, të ndryshuar. Kjo nuk është e kontestuar nga Paditësi/Ankuesi. Prandaj, duke llogaritur nëntë muaj nga 20 dhjetori 2007, kur Paditësi e ka ditur për veprimin e Agjencisë, afati i fundit për parashtrimin e padisë do të ishte 20 shtatori 2008. Paditësi e ka parashtruar padinë më 7 tetor 2008. Prandaj, afati kohor prej 9 (nëntë) muajsh i paraparë ne nenin 6.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 ka skaduar.

## 2. Kërkesa për masën e ndalimit të përkohshëm

Kërkesa e Ankuesit për lëshimin e masës së ndalimit të përkohshëm me të cilën do të ndalohej e Paditura nga shitja e lokaleve në fjalë deri në një vendim përfundimtar të DHPGJS-së – nën rrethanat e veçanta – konsiderohet e pranueshme por e pabazë.

Sipas nenit 55 të Urdhëresës Administrative 2008/6, vendimi që e aprovon masën e ndalimit i takon ekskluzivisht Trupit Gjykues të Dhomës së Posaçme. Nëse trupi Gjykues e lëshon një aktvendim të tillë, ky aktvendim mund të ankimohet tek Kolegji i Ankesave.

Neni 4.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 i jep Trupave Gjykues të Dhomës së Posaçme juridiksion parësor për paditë që lidhen me:

- (a) *Kundërshtimet ndaj vendimeve ose veprimeve të tjera të Agjencisë, të marra në përputhje me Rreguloren nr. 2002/12, duke përfshirë shqiptimin e gjobave, siç*

*është përcaktuar në nenin 27 të Rregullores nr. 2002/12;*

- (b) *Paditë kundër Agjencisë për humbjet financiare që rezultojnë nga vendimet apo veprimet e marra në përputhje me kompetencat e saj si administruese e një ndërmarrjeje apo korporate;*
- (f) *Paditë që kanë të bëjnë me likuidimin e një ndërmarrje sipas autorizimit administrues të Agjencisë dhe paditë për anulimin e transaksioneve të ndonjë ndërmarrjeje që i është nënshtruar procedurës së likuidimit, siç është paraparë në nenin 9.4 të Rregullores nr. 2002/12;*

Neni 55 i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008/6 thotë se Dhoma e Posacmë mund të nxjerrë një aktvendim për masë të përkohshme nëse pala jep prova të besueshme se dëmi, humbja apo dëmtimi i drejtpërdrejtë dhe i pariparueshëm do të kenë pasoja për palën nëse nuk lëshohet aktvendimi për masë të përkohshme. Urdhëresa e lartpërmendur administrative e UNMIK-ut thotë gjithashtu se kërkesa për aktvendim për masë të përkohshme parashtronhet bashkë me padinë ose pas padisë së parashtruar në lidhje me atë padi. Neni 55.5 i Urdhëresës Administrative te UNMIK-ut 2008/6 cek me tutje se nëse paneli gjykues e lëshon një vendim që e aprovon masën e ndalimit të përkohshëm ndaj një pale, mund të parashtronhet ankesë ndaj atij vendimi.

Neni 4.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 thotë:

*Paneli i apelit do të ketë juridikcion ekskluziv për të vendosur mbi ankesat ndaj çdo aktvendimi ose vendimi të panelit gjykues të Dhomës së Posacmë, përveç nëse me këtë Rregullore parashihet ndryshe.*

Neni 58.3 të Urdhëresës Administrative 2008/6 thotë:

*Ndaj vendimit të një gjykate ... (ii) që vendos rrëth një padie për të cilën juridikcionin primar e ka Dhoma e Posacmë, mund të ushtrohet ankesë.*

Nga dispozitat e cituara më lart del se, në parim, kërkesa për masën e ndalimit të përkohshëm duhet të parashtronhet pranë Trupit Gjykues dhe se

kérkesa, që për herë të parë dhe ekskluzivisht është parashtuar pranë Kolegjit të Ankesave, për shkak të mungesës së juridikzionit të Kolegjit të Ankesave, duhet të konsiderohet e papranueshme. Kjo nuk bie ndesh me nenin 55.5 fjalia 2 e UA të UNMIK-ut 2008/6, pasi që dallimi që del nga kjo dispozitë mes masës së ndalimit të përkohshëm të lëshuar nga Trupi Gjykues dhe e lëshuar nga Kolegji i Ankesave e ka ende hapësirën e zbatueshmërisë, si në rastet, në të cilat Trupi Gjykues refuzon të aprovojë masën e ndalimit të përkohshëm dhe paditësi bën ankesë ndaj vendimit, kjo definitivisht do t'i takonte Kolegjit të Ankesave të lëshojë masën e kérkuar të ndalimit të përkohshëm si rezultat i ankesës së suksesshme. Neni 55.5 fjalia 2 e UA të UNMIK-ut 2008/6 nuk ka ndonjë kuptim tjetër përvç si sqarim lidhur me faktin se vendimi i Trupit Gjykues qe e aprovon masën e ndalimit të përkohshëm (kundrejt asaj të Kolegjit te Ankesave) mund të ankimohet (që vlen edhe për vendimin e Trupit Gjykues me të cilën refuzohet kérkesa për masën e ndalimit të përkohshëm.

Në rastin në fjalë, si përjashtim nga rregullat, kérkesa ishte megjithatë e pranueshme.

Një nga arsyet kryesore pse legjislatori ia ka dhënë juridikzionin lidhur me lëshimin e masës së përkohshme në rend të parë shkallës së parë, është që ti jepet Paditësit (ose të Paditurës) mundësi të dëgjohet në dy shkallë, në rast se shkalla e parë vendos kundër tij, edhe nëse do të kishte gjasa të mëdha që Trupi Gjykues pas një vendimi negativ në padinë kryesore, do ta refuzonte gjithashtu edhe kérkesën e parashtuar më vonë për masën e ndalimit të përkohshëm. Ky qellim i ligjit nuk mund të pranohet si një argument valid në rastet kur nuk është e qartë që nga fillimi se e drejta që Paditësi dëshiron t'i mbrohet përmes masës së ndalimit të përkohshëm nuk ekziston (më) nën rr Ethanat e dhëna.

Lënda në fjalë e plotëson pikërisht këtë kriter. Siç është sqaruar më lart sa i përket vet meritave të ankesës, Paditësi – në bazë të fakteve të dorëzuara

nga vet ai dhe që duhet të merren parasysh kur të vendoset për konkludimin e padisë – nuk ka të drejtë të kërkojë anulimin e vendimit të të Paditurit për të anuluar kontratën e shitjes. Kështu që ai nuk ka të drejtë ta ndal të Paditurën që të vazhdojë me procedurën e shitjes.

Për këto arsy, Kolegji i Ankesave konsideron se kërkesa për masën e ndalimit të përkohshëm është e pranueshme por e pabazë.

### 3. Vendimi mbi taksat gjyqësore

Sipas nenin 11 të RREG 2008/4 dhe nenit 66 të UA 2008/6, Trupi Gjykues merr vendim lidhur me shpenzimet e bëra gjatë procedurës gjyqësore në shkallën e parë dhe Kolegji i Ankesave – kur vendos për një lëndë përfundimisht – lidhur me shpenzimet e bëra gjatë procedurave gjyqësore në të dyja shkallët.

Në bazë të nenit 57.2 të UA UNMIK-ut 2008/6 Dhomë e Posaçme ka nxjerrë Rregullat Plotësuese Procedurale lidhur me Taksat Gjyqësore, që janë në fuqi që nga data 10 mars 2010.

Aty thuhet kështu:

‘Neni 10 i Udhëzimit Administrativ Nr. 2008/2 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës të datës 27.11.2008, lidhur me “Tarifat e Taksave Gjyqësore” – me specifikimet e mëposhtme – shpallet të jetë i aplikueshëm për procedurat gjyqësore para DHPGJS-së.

Neni 10.9 deri te neni 10.23 janë të aplikueshëm – mutatis mutandis – për procedurën ankimore para Trupit Gjykues dhe para Kolegjit të Ankesave.

Si sqarim, neni 10.11 është i aplikueshëm edhe për procedurën që drejton ankinin kundër aktvendimeve të shkallës së dytë të Trupit Gjykues.

(...)

Këto Rregulla Plotësuese Procedurale kanë hyrë në fuqi më 10 mars 2010 dhe vlejnë deri më 31 dhjetor 2010.'

Taksat gjyqësore në të dyja shkallët përbëhen, në njérën anë nga një taksë për ushtrimin e parashtresës(ave), në anën tjetër nga një taksë për lëshimin e (një) aktvendimi(eve).

Pasi që aktvendimi i shkallës së parë është lëshuar një ditë para hyrjes në fuqi të rregullave të lartpërmendura, këtu do të shqyrtohen vetëm taksat gjyqësore për procedurën e ankimeve.

Shuma e taksës për ushtrimin e ankesës siç rregullohet me nenin 10.11 të Urdhèresës Administrative të Këshillit Gjyqësor të Kosovës Nr. 2008/2 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore ("ADJ") është 30,-- Euro.

Neni 10.15 ADJ përcakton se për aktvendimet për hedhjen e padive (si të papranueshme) duhet të paguhet vetëm gjysma e taksës të rregulluar në nenin 10.1 ADJ (që parimisht i bazon taksat gjyqësore në vlerën e padisë), deri në shumën maksimale prej 30,-- Euro. Kjo vlen edhe për aktvendimet në shkallën e dytë (neni 10.21 ADJ i referohet neneve 10.12 deri 10.18 ADJ). Neni 10.15 në lidhje me nenin 10.21 përfshin aktvendimet në shkallën e dytë që hedhin poshtë ankesat si të papranueshme, si dhe aktvendimet mbi ankesat kundër aktvendimeve të shkallës së parë që nuk i prekin meritat e lëndës.

Përveç kur vlera e padisë dëshmohet të jetë më e vogël (në shkallën e parë nga paditësi, në shkallën e dytë nga ankuesi), sipas nenit 10.1 në lidhje me nenet 10.15 dhe 10.21, taksa gjyqësore është 30,-- Euro.

Në lëndën në fjalë, as në shkallën e parë e as në shkallën e dytë nuk janë bërë deklarimet për vlerën e padisë. Prandaj, taksa gjyqësore për aktvendimin në shkallën e dytë është përcaktuar 30,-- Euro.

Në përgjithësi, për procedurat e ankimeve vlejnë taksat gjyqësore në vijim:

Tarifat e taksave gjyqësore, neni	30 Euro
10.11	
(ushtrimi i ankesës)	
Tarifat e taksave gjyqësore, neni	30 Euro
10.15 lidhur me 10.21 dhe 10.1	
(aktvendimi në shkallën e dytë)	
Gjithsej	60 Euro

Taksat gjyqësore do të barten nga Ankuesi.

Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues i EULEX-it Nënshkrimi

Torsten Koschinka, Gjyqtar i EULEX-it Nënshkrimi

Eija-Liisa Helin, Gjyqtare e EULEX-it Nënshkrimi

Tobias Lapke, Regjistrues i EULEX-it Nënshkrimi